



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr.1344/1 prot.

Tiranë, më 28.12.2023

**V E N D I M**

**Nr. 262, datë 28.12. 2023**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën nr. 259 Regj., datë 07.12.2023, që i përket ankueses A.L<sup>3</sup> kundër Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë<sup>4</sup>, me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve politike dhe për çdo shkak tjetër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit, ankuesja ka parashtruar se, është mësuese matematike-fizike që prej shtator 1992 e deri tani (31 vite) me emërim definitiv. Prej muajit shkurt 2009, ajo është me emërim definitiv në institucionin arsimor (IA) “Pashko Vasa”. Më datë 12.04.2021 i është drejtuar me ankesë Komisionerit, i cili me vendimin nr.180, datë 23.09.2021 ka vendosur, konstatimin e diskriminimit të ankueses A.L, për shkak të bindjeve politike, nga ana e DRAP Lezhë dhe marrjen e masave nga DRAP lezhë për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të ankueses. Ankimi konsistonte në faktin që ankuesja kishte konkuruar për një vend të lirë pune, drejtuese e institucionit arsimor “Pashko Vasa” pranë të cilit punonte si mësuese, dhe në shkelje të gjithë afateve, procedurave, metodologjisë, udhëzimeve, në këtë pozicion pune u

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin Ankuesja.

<sup>4</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin DRAP Lezhë.

emërua si drejtuese E.Rr. Ky emërim konkludoi i paligjshëm edhe nga hetimi administrativ i KMD dhe hetimi penal i Prokurorisë së Rrethit Shkodër.

Ankuesja pretendon se ankimi pranë Komisionerit i ka sjellë pasoja në lidhje me marrëdhëniet e punës, tashmë jo më si kandidate për drejtuese, por si mësuese e shkollës “Pashko Vasa”, pas emërimit të drejtueses së shkollës, pas datës 17.03.2021.

Ankuesja parashtron se, pas ankimit të bërë prej saj tek Komisioneri, ka filluar thellimi i diskriminimit ndaj asaj, pasi kudo ku është ankuar si, ZVAP, DRAP, DPAP dhe MASR, nga mbështetja që gëzonte drejtoresha e re dhe nga eksperiencia e ankimeve që unë mora për garën si drejtuese e IA, nuk po arrin të gjejë drejtësi. Ndaj saj filluan kërcënimet me vendin e punës, tashmë si mësuese. Ankuesja parashtron faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

1. Me datë 04.05.2021, me shkresën nr.892 prot, i është drejtuar drejtoreshës së shkollës dhe ZVAP Shkodër me kërkesën me objekt “ Konfirmim për shqyrtim dosje (nëse ka) për profil/lënde Matematikë-Fizikë, në mbyllje të procesit mësimor qershor 2021, në IA “Pashko Vasa”.
2. Me datë 14.05.2021, me shkresën nr.491/3 prot, ka marrë nga drejtoresha e shkollës E.R, përgjigjen që, referuar udhëzimit nr.13, datë 22.05.2019 të MASR, shkolla nuk krijon KVD por DRAP Lezhë. Kjo përgjigje nuk është në përputhje me pikat e udhëzimit ku përcaktohen rastet kur drejtorja e shkollës krijon KVD.
3. ZVAP Shkodër nuk kthen përgjigje.
4. Me datë 28.06.2021, me shkresën të Komisionerit është thirrur në seancë dëgjimore. Shkresa i është drejtuar ZVAP Shkodër, DRAP Lezhë dhe ankueses. Me datë 29.06.2021, drejtoresha e shkollës deklaroi në Këshillin e Mësuesve se i është hequr dita e punës për datën 28.06.2021, për mungesë në punë, pasi ankuesja ka qenë në seancë dëgjimore pranë Komisionerit.
5. Me datë 01.07.2021, me shkresën nr.1607 prot, i është drejtuar me kërkesë ZVAP Shkodër, duke argumentuar se me ZVAP dhe DRP, atë e lidhte puna dhe në seancë ishte për shkak të funksionit dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij. Për sa kohë të dy juristet e ZVAP dhe DRAP janë paguar në datë 28.06.2021, pse nuk paguhet ankuesja. Listë pagesat firmosen nga drejtoresha e ZVAP çdo muaj përveç drejtoreshës së shkollës.
6. Përgjigja e ZVAP Shkodër, me shkresën nr.1607/1 prot, ishte që në listëprezencë ka mungesë për datën 28 dhe kjo ishte arsyeja që nuk ishte paguar.
7. Me datë 08.07.2021, me urdhër nga drejtoresha e shkollës për ngritjen e KVD (është afishuar më vonë), është specifikuar që në konkurim kalojnë CU, Gjuha Shqipe, Gjuha Huaj, Histori-Gjeografi, Edukimi Fizik, kurse profili Matematikë dhe Fizikë, jo konkurim, por dy mësuesit vijojnë punën, kurse ankuesja me diplomë matematikë-fizikë, largohet vetëm me pikëzim, në lëvizje të detyruar, pa konkurim.
8. Në grupin WhatsApp, përmenden disa profil/lënde për konkurim, duke përjashtuar matematikë-fizikën nga konkurimi, pasi konfirmon që do pikëzohet dhe niset dosja e ankueses pa konkurim

me kolegun matematikë, pa konkurim me kolegen fizikë, tashmë të rikthyer pas 1 viti pune në një shkollë tjetër në juridiksioni të ZVAP Shkodër.

9. Nga hakmarrja për ankimin pranë Komisionerit, ankuesja ka kërkuar ndërhyrjen e ZVAP dhe DRAP. Me datë 12.07.2021, me shkresën nr.1833 prot, ka bërë ankim në ZVAP, DRAP, DPAP dhe Portalin e Bashkëqeverisjes. Kjo e fundit e delegon problemin në DRAP Lezhë dhe e detyron të kthejë përgjigje. Thelbi i përgjigjes ishte: *“Për sa më sipër, znj.A.L, profili matematikë fizikë, do të rankohet me mësuesin tjetër në këtë institucion arsimor të profilit fizikë. Theksojmë se diploma që disponon znj.L, bazuar në nenin 57, të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor në RSH”, i ndryshuar është formim universitar në ushtrimin e profesionit të mësuesit të lëndës matematikë-fizikë. Në fund të e-mailit, N. M, juriste DRAP Lezhë.”*
10. ankuesja paraqitet në punë me datë 30.08.2021. Në Këshillin e Mësuesve është afishuar vlerësimi i dosjeve nga KVD, ku është listuar e para me 35 pikë dhe kolegia e fizikës me 28 pikë.

Sipas ankueses, konstatohen këto paligjshmëri:

1. Konkurimi selektiv vetëm për fizikë dhe po trajtohet vetëm si mësuese fizike.
2. Drejtoresha deklaron që nuk lejohet të japë matematikë me urdhër të DRAP Lezhë, prandaj nuk ka kaluar në pikëzim kolegu i lëndës matematikë.
3. Nuk ka kaluar në konkurim dosje CU, Gjuha Shqipe, Histori-Gjeografi edhe pse me urdhër janë parashikuar dhe orët mësimore nuk plotësojnë ngarkesën e numrit të mësuesve specifikisht (Ankuesja sqaron se, ngarkesa mësimore bie nëse largohet një klasë në të gjitha profilet dhe lëndët që ka ajo klasë, pra jo vetëm në një lëndë, siç pretendojnë, pra vetëm në fizikë)
4. Me datën 01.09.2021, i është konfirmuar, që edhe pse ka konkuruar dhe është listuar e para në pikëzim, përsëri dosja ikën me lëvizje të detyruar në ZVAP Shkodër, pasi IA (Shkolla P.Vasa) edhe pse ka në dispozicion 200 orë për 4 klasa AMU, vetëm për ankuesen nuk disponon orë.
5. Me datë 02.09.2021, me shkresën nr. 2448 prot ankuesja ka bërë një ankim drejtuar DRAP Lezhë, DPAP dhe MASR, nëpërmjet të cilit ka kërkuar monitorimin e procedurave të lëvizjes paralele në IA Shkolla “Pashko Vasa”, duke specifikuar shkeljet ligjore dhe argumentuar pse është e qëllimshme (urdhri i DRAP Lezhë) dhe keqdashëse lëvizja e detyruar edhe pse gara ka qëllim të shpallë fitues të vendit të punës. Ankimi është dërguar gjithashtu edhe me postë elektronike.

Sipas ankueses, e gjithë kjo është hakmarrje për shkak të ankimit tek Komisioneri dhe ankuesja pretendon se po merr pasoja duke cenuar në mënyrë vijuese marrëdhëniet e punës.

Duke iu referuar periudhës qershor 2020-qershor 2021, ankuesja saktëson :

1. Rrethanat në shkollë nuk kanë ndryshuar, duke iu referuar këtu numrit të nxënësve dhe numrit të orëve mësimore, numrit të klasave.

2. Rrethanat e ankueses si mësuese janë të njëjta, përveç kualifikimeve të shumta gjatë vitit.
3. I njëjti DRAP, në qershor 2020, me *e-mail* deklaroi se ankuesja duhet të konkurojë edhe në matematikë për 16 orë matematikë edhe në fizikë për 7 orë fizikë, ndërsa në qershor 2021, dërgoi e-mail për konkurim selektiv vetëm për 7 orë fizike. (Në të dy rastet me dy standarte të ndryshme, emri në fund të e-mailit është N. M, juriste e DRAP Lezhë). Ka ndryshuar vetëm fakti që ankuesja ka paraqitur ankesë tek Komisioneri. Kjo shihet si hakmarrje e hapur duke e kërcënuar me cenim të marrëdhënieve të punës, dukshëm tendencioze, pasi 7 orë fizikë nuk përbëjnë vend pune.

Përgjigje ka ardhur vetëm nga DPAP, e cila shprehet: “Për kontratat e nënshkruara në shkelje të legjislacionit në fuqi ngarkohet me përgjegjësi ish drejtori i shkollës z.G, për të cilin do të ndiqen procedurat përkatëse ligjore si dhe drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar....., nga informacioni që kemi marrë, ngarkesa mësimore bie në profilin fizikë dhe sipas udhëzimit, vlerësimi i dosjeve duhet të kryhet vetëm për profilin Fizikë, profil në të cilin ka rënë ngarkesa mësimore (ngarkesë mësimore kuptohet numri i orëve mësimore, i cili nuk ka ndryshuar. Ngarkesa nuk parashikon kthim në shkollë të mësueses nga kontrata të paligjshme që një vit mësimor në shkelje të ligjit merr rrogën dhe 20 orë mësimore i bën tek një shkollë tjetër.)

Në këtë rast do të vlerësohen dosjet e dy mësuesve, të profilit Matematikë-Fizikë dhe Fizikë të cilët janë të punësuar aktualisht në Institucionin Arsimor “Pashko Vasa” me kontratë pune definitive.

Ankuesja, deklaroi se ka dërguar përsëri një *e-mail*. Në kthim përgjigje DPAP-it ankuesja konfirmon që përgjigja nga ana e saj bazohet në dy fakte:

1. Marrëveshjet e paligjshme midis drejtorit të shkarkuar dhe mësueses që konkuroi me të.
2. DPAP, i referohet informacioneve të marra nga drejtoresha e shkollës e cila cilëson “rënie ngarkese” vetë në lëndën fizikë, kur në fakt 7 orë ishin në qershor 2020 dhe 7 orë në qershor 2021. Pra nuk ka rënie dhe fakti që ankuesja kalon në KVD është i pabazuar në udhëzimin nr.12. Kjo ishte arsyeja që ankuesja ka kërkuar monitorim nga organet eprorë, pasi drejtoresha e shkollës (e ardhur në paligjshmëri dhe shkelje të procedurave të konkurimit) po vepron duke cenuar marrëdhëniet e saj të punës dhe duke iu referuar urdhrin të DRAP Lezhë.
3. Tashmë ankuesja po trajtohet nga ZVAP dhe DRAP, vetëm si mësuese e lëndës fizikë me justifikimin që organi epror DPAP (drejtoresha me e-mail nis urdhrin e DRAP) ka specifikuar konkurim vetëm në fizikë. Me këtë justifikim, ankuesja rankohet në portalin e ZVAP Shkodër e para (me 35 pikë) vetëm në fizikë.
4. I hiqet e drejta të japë lëndën matematikë, pas 29 vitesh edhe pse ka titullin mësuese e matematikës, Titull “Mjeshtër” dhe vlerësim “shumë mirë”, në kualifikimet e lëndës matematikë.
5. Fillojnë ofertat e punës të paligjshme, pasi trajtohet si mësuese Portali dhe është e para. Njoftohet me e-mail dhe nëse nuk paraqitet me datë 07.09.2021 në orën 9:00 në ZVAP i humb e

- drejta e punësimit. Ankuesja paraqitet në orarin e caktuar dhe nga komisioni në ZVAP i ofrohet vend pune i lirë (definitive) në shkollën “ Mehmet Shpendi”, Breg Lumi, Theth. Kjo shoqërohet edhe me sanksionin që nëse refuzon i zgjidhet kontrata e punës. Ankuesja iu ka saktësuar se ishte në pritje të përgjigjes së ankimit të depozituar dhe të argumentimit se pse ishte në lëvizje të detyruar, pasi kishte orë në përshtatje të diplomës dhe pikëzimit në shkollë, si dhe se vinte nga një konkurim që kishte fituar 7 orë fizikë në shkollë, pra ishte prezent me konkurim në shkollë.
6. Thirret përsëri pas dy ditëve, ku i ofrohen orë mësimore në shkollën ku është dhe në dy shkolla të qytetit Shkodër dhe në Rragam (pra 3 orë ktej, 2 orë andej.....) praktikisht të pamundura për atë si mësuese “Mjeshtre”, me eksperiencë të gjatë 30 vjeçare në lëndën matematikë-fizikë dhe si kryefamiljare që ka në ngarkim dy fëmijë.
  7. Më datë 23.09.2021, ankuesja thirret përsëri në ZVAP, ku tashmë përveç komisionit të ZVAP ishte prezent edhe drejtori i DRAP Lezhë, z. B.P. Ankueses i ofrohet përveç 7 orë fizikë në shkollë, orë mësimi tek Gjimnazi “28 Nëntori” ose orë në shkollën 9 vjeçarë “Branko Kadia”.
  8. Nga biseda në zyrë të drejtores së ZVAP, ankuesja kupton qëllimin për ta larguar me çdo kusht nga IA “P.Vasa” ku vijonte punën si definitive që në shkurt të vitit 2009 dhe ku kishte konkurruar si drejtuese.
  9. E ndodhur para një fakti të tillë të imponuar, ankuesja ka deklaruar se nuk pranon orë në shkollat e tjera por vetëm në shkollën e saj, pasi shkolla disponon 200 orë mësimore dhe nëse listohen në pikëzim të gjithë kolegët (20 gjithsej), ajo ishte e para me pikë (35 pikë) dhe se kishte kritere në ndarjen e ngarkesës mësimore, ku pasi të vlerësohet diploma, performanca dhe pikët e dosjes, duhet të bëhet rankimi i mësuesve. Në bazë të performancës dhe pikëzimit, me dosje ankueses i takojnë orë matematike, TIK, fizikë etj, (orë jo të profilizuara që IA i disponon)
  10. Ndërkohë, me datë 27.09.2021, ku fillon procesi mësimor, zyrtarisht ankuesja ka vetëm 7 orë fizikë (duhen 20 orë për të marrë pagën e plotë). Referuar ngarkesës mësimore dhe orarit mësimor në Këshillin e Mësuesve, pas 29 viteve punë ajo ka 1/3 e ngarkesës mësimore dhe rrezikon të paguhet me 1/3 e pagës.
  11. Pas fillimit të procesit mësimor dhe njohjes me ngarkesën mësimore ankuesja ka ankimuar në ZVAP Shkodër, faktin që mësuesja e fizikës që konkuron me dosje me atë dhe humb nga ky konkurim i jepen në orarin mësimor dhe ngarkesë të shpallur në Këshillin e Mësuesve 6 orë TIK ndërsa ankueses vetëm 7 orë fizikë. Bashkë me ankesën, ankuesja ka paraqitur programin e studimit të degës fizikë 27 lëndë gjithsej (1 lëndë informatikë) dhe programin e studimit matematikë fizikë 42 lëndë (1 lëndë informatikë), duke kërkuar argumentim pse favorizohet kur është renditur e dyta në konkurim me dosje.
  12. Pasi ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë janë njohur me vendimin nr.180, datë 23.09.2021 të Komisionerit, ankuesja është thirrur në ZVAP Shkodër me datë 06.10.2021 ku i kanë konfirmuar 20 orë mësimore të gjitha në Shkollën “Pashko Vasa” ku është definitive. Ky veprim është bërë i sforcuar dhe i imponuar, pasi të gjitha institucionet ZVAP Shkodër dhe DARLezhë janë të frikësuar nga vendimi i Komisionerit, i cili ka konstatuar diskriminimin dhe ka kërkuar ndreqjen e paligjshmërisë. Duke mos patur burim tjetër të ardhurash detyrohet të pranojë edhe pse janë 10 orë “detyra shtëpie”, 7 “fizikë” etj dhe asnjë orë matematikë)

13. Të gjitha këto ngjarje janë pas datës 17.03.2021, kur me urdhër nr.70, erdhi me emërim drejtoresha e re nga gara e konkurimit për drejtues.

Ankuesja shprehet se, këto veprime të paligjshme me urdhër të mbuluar nga DAR Lezhë i kanë shkaktuar një dëm të konsiderueshëm, i kanë cenuar sigurinë juridike në punë si mësuese “Mjeshtre” dhe me 30 vite eksperiencë si mësuese Matematikë-Fizikë, për të cilën është diplomuar.

Veprimet e DRAP Lezhë janë haptazi në kundërshtim me nenin 57, të ligjit 69/2012 dhe me udhëzimin 13 (i ndryshuar me udhëzimin 20) të MASR, udhëzimin nr.12, të MASR, duke cenuar pozitën e saj si mësuese definitive dhe duke e konsideruar me pa të drejtë si mësuese portali.

Pas 30 viteve punë, për shkak të ngarkesës me 1/3 të dhënë fillimisht, i është rrezikuar paga, duke i ofruar vetëm 1/3 e saj, në një kohë që, jo vetëm ka vend në shkollë, por dhe ka ulur ndjeshëm reputacionin si mësuese me karrierë 30 vjeçare. Frika e cungimit të pagës e ka shqetësuar si kryefamiljare që ka dy fëmijë në ngarkim (të cilët janë të papunë).

Ankuesja thekson se, nëse do të ishte zbatuar ligji dhe aktet nënligjore nga ana e DRAP Lezhë (dhe nuk do kishte emërim të paligjshëm të drejtuesit të IA “Pashko Vasa”) ajo nuk do të kishte marrë asnjë nga pasojat e parashtruara. Të gjitha veprimet e paligjshme të cilat janë pasojë e emërimit të paligjshëm, hakmarrjes për ankimin e saj tek Komisioneri, tregojnë qartë thellimin e diskriminimit, për arsye politike dhe shkaqe të tjera, siç është mosmarrja e masave për zhdukjen e shkakut diskriminues. Gjendja diskriminuese vazhdon dhe është vijuese edhe pse Gjykata Administrative e Tiranës me vendimin nr.1255, datë 20.04.2022, ka vendosur rrëzimin e padisë së palës paditëse DRAP Lezhë si të pabazuar në prova dhe ligj.

DRAP Lezhë nuk ka marrë asnjë masë për ndërprerjen e paligjshmërisë, për të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së ankueses, por përkundrazi ka vazhduar me thellimin e diskriminimit (duke cenuar edhe marrëdhënien e punës si mësuese) dhe nga moszbatimi i vendimeve, mosmarrjen e masave për zhdukjen e shkakut diskriminues.

Ankuesja pretendon se, koha e diskriminimit të pretenduar dhe marrja dijeni për këtë pretendim është data 17.03.2021 – 15.06.2022. Ankuesja sqaron se, kërkesa paraqitet në këto momente pasi DRAP Lezhë ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Tiranës vendimin nr.180 të KMD, i cili tashmë është i formës së prerë.

Përfundimisht, ankuesja kërkon nga Komisioneri: - konstatimin e diskriminimit vijues (vazhdues) nga mosmarrja e masave për zhdukjen e shkakut diskriminues; - konstatimin e thellimit të diskriminimit si pasojë e bindjeve politike (pasi kjo ka ardhur si hakmarrje e ankimit tek Komisioneri dhe për t’u larguar me çdo kusht nga shkolla ku është definitive për të mbrojtur pozitën e drejtoreshës së re të sjellë nga vetë DRAP Lezhë, në mënyrë të paligjshme dhe me mbrojtje

politike) si organ epror që ka nxjerrë urdhrin nr.70, emërim i drejtorit në IA “Pashko Vasa”; - si dhe marrjen e masave për zhdukjen e shkakut diskriminues që në vazhdimësi të jetë e sigurt për vendin e punës

## **I. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: *“çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Bazuar në aktet e administruara, rezulton se, ankuesja A.L, i është drejtuar më herët institucionit të Komsionerit me ankesën nr.64, datë 12.04.2021, të paraqitur kundër Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Lezhë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), me pretendimin se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, gjatë procedurës së ndjekur për emërimin e drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Pashko Vasa” Shkodër. Komisioneri ka dispozuar në lidhje me këtë ankesë me vendimin nr.180, datë 23.09.2021, duke vendosur: *“1. Konstatimin e diskriminimit të ankueses A. L, për shkak të bindjeve politike, nga ana e DRAP Lezhë. 2. Në referim të pikës 1, DRAP Lezhë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të ankueses. ...”.*

DRAP Lezhë ka kundërshtuar vendimin nr.180, datë 23.09.2021, të Komisionerit, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me vendimin nr. 1255 datë 20.04.2022, ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë së palës paditëse Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë si të pabazuar në prova dhe në ligj”.* Ky vendim rezulton të ketë marrë

formë të prerë në datën 08.05.2022, pasi nuk është ankimuar nga palët. Pas marrjes formë të prerë të vendimit të gjykatës dhe faktit që DRAP Lezhë, nuk zbatoi vendimin nr. 180, datë 23.09.2021, Komisioneri me vendimin nr. 41, datë 20.03.2023, vendosi të gjobisë DRAP Lezhë me 100.000 lekë, për moszbatim të vendimit.

Ankuesja A.L, ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi nr.259 datë 07.12.2023, duke pretenduar se, pas datës 17.03.2021, moment kur është emëruar nga DRAP Lezhë, drejtuesja e re e shkollës, e emëruar në përfundim të procedurës së konkurimit të ndjekur për emërimin e drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Pashko Vasa” Shkodër, procedurë kjo e konstatuar si diskriminuese në dëm të ankueses sipas vendimit nr.180, datë 23.09.2021 të Komisionerit, ndaj saj kanë ardhur pasoja negative dhe ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të disfavorshëm, që sipas saj kanë ndodhur për shkak të ankimit që kishte bërë pranë Komisionerit. Ankuesja pretendon se për shkak të ankimit që ka bërë tek Komisioneri, për vitin mësimor 2021/2022, i është ulur fillimisht ngarkesa mësimore me 1/3, duke i cenuar pagën dhe rrezikuar vendin e punës. Ankuesja pretendon se, pasi DRAP Lezhë dhe ZVAP Shkodër kanë marrë dëgjimin për vendimin nr.180, datë 23.09.2021 të Komisionerit i kanë konfirmuar ngarkesë të plotë mësimore për vitin 2021/2022, të gjitha në shkollën ku ajo është definitive, por sipas saj ky ka qenë një veprim i sfocuar dhe i imponuar nga ana e tyre, por edhe nga ana e saj, pasi ka pranuar për shkak se nuk kishte burim tjetër të ardhurash. Pavarësisht se ngarkesa mësimore për vitin 2021/2022 nga 1/3 u bë ngarkesë e plotë, ankuesja pretendon se i është cenuar siguria juridike në punë si mësuese matematike-fizike, për të cilën është diplomuar, pasi nuk është lejuar që të japë orë matematike, por i janë dhënë vetëm 7 orë fizike, ndërsa ngarkesa e plotë i është plotësuar me orë mësimore jashtë profilit si “detyra shtëpie”, por asnjë orë matematikë.

Ankuesja pretendon se e gjitha procedura e ndjekur për caktimin e ngarkesës së saj mësimore për vitin 2021/2022, ka qenë diskriminuese dhe ka ndodhur për shkak të ankimit që ajo kishte paraqitur tek Komisioneri, të cilat ankuesja i konsideron si diskriminim vijues dhe thellim i diskriminimit, të konstatuar nëpërmjet vendimit nr.180, datë 23.09.2021, të Komisionerit.

Nga verifikimet e kryera nga ana e Komisionerit, rezulton se, ankuesja ka paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, kërkesë padi kundër DRAP Lezhë, me objekt konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike, duke kërkuar nga gjykata rregullimin e pasojave që rrjedhin nga ky diskriminim dhe detyrimin e DRAP Lezhë për shpërblimin e dëmit të pësuar si pasojë e diskriminimit. Në bazën ligjore të kërkesë padisë ankuesja ka vendosur ndër të tjera, nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Protokolli 12-të i Konventës, ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar dhe neni 9/1.2 të Kodit të Punës. Kërkesa padia i është njoftuar Komisionerit nëpërmjet fletëthirrjes administrative, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me nr. 784/1694, datë 01.11.2022, administruar pranë Komisionerit me nr.1605 prot datë 19.12.2022.



Aktualisht, kjo çështje është duke u shqyrtuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të riorganizuar, në kuadër të Hartës së Re Gjyqësore.

Referuar parashtrimeve të bëra nga ankuesja në kërkesë padinë ( e cila është administruar dhe depozituar në dosje), që ajo ka paraqitur në gjykatë, konstatohet se, ankuesja kërkon nga gjykata konstatimin e diskriminimit në lidhje me dy momente:

- Kërkimi i parë për diskriminim ka të bëjë me, procedurën e ndjekur për emërimin e drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Pashko Vasa” Shkodër. Në lidhje me këtë pretendim është shprehur edhe Komisioneri me vendimin nr.181, datë 23.09.2021.
- Kërkimi i dytë për diskriminim ka të bëjë me procedurën e ndjekur për caktimin e ngarkesës së saj mësimore për vitin 2021/2022, të cilën ankuesja para gjykatës e parashtron si vazhdim i gjendjes diskriminuese/diskriminim vazhdues, që i ka ardhur për shkak të ankimit që ka bërë pranë Komisionerit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar pranë Komisionerit, si dhe bazuar në kërkesë-padinë që ankuesja ka paraqitur pranë gjykatës administrative, konstatohet se, në lidhje me kërkimin e dytë për diskriminimin i cili ka të bëjë me procedurën e ndjekur për caktimin e ngarkesës së saj mësimore për vitin 2021/2022, të njëjtat fakte, rrethana e shkaqe që janë paraqitur edhe përpara Komisionerit në ankesën objekt shqyrtimi janë bërë prezent në parashtrimet e paraqitura para gjykatës, nga ana e ankueses.

Sa më sipër, rezulton se, pretendimi i ngritur nga ankuesja për diskriminim në ankesën objekt shqyrtimi, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankueses, të njëjtat fakte, rrethana, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor. Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, do të pushonte çështjen nëse ajo do të ishte në shqyrtim e sipër.

Bazuar në nenin 36/4, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), nenin 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 259 Regj., datë 07.12.2023, të paraqitur nga ankuesja A.L, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Bindje politike, çdo shkak tjetër  
Fusha: Punësim  
Lloji i vendimit: Mospranim (Gjykatë)